



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtarit në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie,
2. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga tetë deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës,
3. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, e mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.
4. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale,
5. Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim.

Dnevni red

1. Osnivanje ad hoc komisije za izbor 1 (jednog) člana Borda za žalbe Nezavisne komisije za medije,
2. Osnivanje ad hoc parlamentarne komisije, prema zahtevu poslanice Shqipe Pantina, podržan od osam (8) ostalih poslanika PG Pokerta Vetëvendosje, u vezi Radio televizije Kosova,
3. Parlamentarna rasprava prema zahtevu poslanice Margarita Kadriu-Ukelli, podržan i od 9 (devet) ostalih poslanika potpisnika, u vezi mogućih finansijskih obavezivanja Kosova, prema zahtevu kompanija koje su podnele žalbu pri Međunarodnom sudu arbitraže.
4. Glasanje N/zakona o izmena i dopunama Zakonika o krivičnom postupku,
5. Glasanje godišnjeg finansijskog izveštaja Generalnog revizora za 2015 godinu,
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona o akreditaciji.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Kolegë deputetë, nëse kam mirëkuptimin tuaj, nuk besoj se zgjat mbi 15 minuta, të përfundojmë vazhdimin e seancës. I kemi vetëm disa pika për votim!

Pra, mund të zgjasë vetëm 15 minuta, me mirëkuptimin tuaj, do të vazhdojmë. Dhe, të gjitha janë për votime, janë prezentë 71 deputetë.

Pra, faleminderit për mirëkuptimin tuaj! Vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

I hap punimet e vazhdimin të seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të filluara më 28 tetor e 17 nëntor, dhe 30 nëntor e 1 dhjetor 2016.

Pra fillojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie

Në seancën e mbajtur më 17 nëntor 2016 grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie, si në vijim:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka propozuar deputeten Selville Halimi kryetare dhe deputeten Xhevahire Izmaqi, anëtare.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka propozuar deputetët Armend Zemaj dhe Blerim Grainca.

Grupi i AAK-së e ka propozuar deputetin Lahi Brahimaj për anëtar.

Grupi Parlamentar “Nisma” e ka propozuar deputetin Zafir Berisha për anëtar.

Grupi Parlamentar “6+” e ka propozuar deputeten Duda Balja për anëtare.

Ndërsa, deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk ishin të pranishëm në seancë, ata tani mund t’i propozojnë anëtarët e këtij komisioni.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që ta propozojë 1 deputet për zëvendëskryetar të parë të komisionit. Urdhëro, kryetar i Grupit Parlamentar. Fjalën e ka zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Ne, për anëtar dhe zëvendëskryesues të këtij komisioni e propozojmë Mytaher Haskukën.

KRYETARI: Faleminderit! E kemi propozimin për zotin Mytaher Haskuka. Lista serbe nuk është e pranishme.

Atëherë, vazhdojmë me votimin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim formal me dorë dhe votojmë tash!

Të gjithë janë për. A ka ndonjë kundër?
Abstenim? Nuk ka.

Atëherë, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie.

Në sallë janë të pranishëm 68 deputetë.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me ligjin për Komisionin e Pavarur për Medie dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me rekomandime.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim

Të nderuar deputetë,
Ju njoftoj se në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016, me rastin e votimit të amendamenteve në Projektligjin për akreditim është bërë një lëshim nga administrata.

Në raportin e Komisionit FunkSIONAL kanë qenë të propozuara 27 amendamente, ndërsa në skenarin për drejtimin e seancës kanë qenë të radhitura 21 amendamente, të cilat janë miratuar së bashku me tekstin e projektligjit.

Në mbledhjen e Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 19 dhjetor 2016, është vendosur të procedohet projektligji për votim me të gjitha amendamentet përsëri.

Prandaj, kërkoj mirëkuptimin tuaj që t'i votojmë amendamentet dhe në fund tekstin e ligjit me amendamente.

Në këtë projektligj nga Komisioni FunkSIONAL janë propozuar 27 amendamente.

Vazhdojmë votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Aktualisht i kemi 68 deputetë në sallë, i kemi 27 amendamente. Nëse nuk ka kundër, do t'i votojmë të gjitha përnjëherë.

A jeni për t'i votuar përnjëherë të gjitha?
Kush është kundër?
Abstenim? Nuk ka.

Atëherë, lus Administratën, sa deputetë janë të pranishëm në sallë. Jemi duke e votuar tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, votojmë tash!

Kanë votuar 58 deputetë, 54 janë për dhe 4 kanë abstenuar.

A të votojmë edhe një herë, jemi 67 deputetë në sallë, sepse duhet të jenë 61.

Pra, votojmë edhe një herë. Kishin votuar 3 me dorë.

Por, sido që të jetë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara dhe votojmë tash:

Janë 63 deputetë në mënyrë elektronike. Sa janë që kanë votuar me dorë? 2 deputetë, a janë për apo kundër? Janë për!

Pra, 65 deputetë kanë votuar në tërësi. Janë 63 në mënyrë elektronike dhe 2 me dorë.

Pra, 59 janë për, 6 kanë abstenuar.

Dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për akreditim.

- Votimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016, andaj në seancën e sotme procedojmë me votimin e raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

61 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, 2 kanë votuar me dorë, që do të thotë se janë gjithsej 63, nga të cilët 50 kanë votuar për, 13 kanë abstenuar.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.

- Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, e mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 17 nëntor 2016, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk është proceduar më tej për këtë pikë.

Ndërkohë, deputetja Margarita Kadriu-Ukelli i ka propozuar Kuvendit miratimin e rekomandimeve lidhur me këtë pikë.

Rekomandimet e deputetes u janë shpërndarë deputetëve, andaj në seancën e sotme procedojmë me votimin e rekomandimeve të propozuara nga deputetja Margarita Kadriu-Ukelli.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Të nderuar deputetë, janë 54, përkatësisht 56 deputetë dhe propozoj të votojmë edhe një herë, sepse na duhen 61.

Të pranishëm janë 64 deputetë. Votojmë, pra edhe një herë, dhe kjo është vendimtare.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

I kemi 57 deputetë që kanë votuar, duke i pasur parasysh edhe 2 vota të deputetëve me dorë.

Atëherë konstatoj, meqë s'ka kuorum të mjaftueshëm, kanë votuar 57 deputetë që s'mjaftojnë.

- Formimi i Komisionit hetimor parlamentar sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga 8 deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 17 nëntor 2016, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nisma” kanë propozuar deputetët për kryesues, zëvendëskryesues dhe anëtarë të këtij komisioni, ndërsa Grupi Parlamentar i PDK-së e LDK-së, Lista serbe dhe “6+” nuk i kanë propozuar deputetët nga radhët e tyre për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Të nderuar deputetë, kjo ka qenë disa herë... unë e kam sjellë edhe sot. Në qoftë se s'kemi gatishmëri, këtë çështje s'kemi as çka ta sjellim në seancë plenare.

Unë edhe në Kryesi, edhe kolegët e Kryesisë e dinë, e kam sjellë me kërkesën time.

(Ndërhyrje)

Po, s'ka anëtarë dhe s'kam as çka të hedh në votim në qoftë se grupet parlamentare nuk i sjellin të propozuarit.

Jam duke folur për PDK-në, LDK-në, Listën serbe dhe “6+”.

(Ndërhyrje)

Po s'kam çka të nxjerr në votim? Unë me këtë rast duhet të procedoj, e qëndrimi politik është tjetër, unë votoj por si kryetar i Kuvendit jam i obliguar të procedoj.

Atëherë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe i LDK-së, reagojnë me kokë. “6+” me kokë!

Atëherë, meqë s'ka anëtarë të propozuar, më vjen keq! Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*